



## OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

### DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

**Drejtuar:** BOE - “ALB-GERALD 2023” sh.p.k. me NIPT M31910029T  
Adresa: Njesia Administrative 11, Rruga “Ramadan Sokoli”,  
Godina Nr. 36, Laprakë, Tiranë.  
- “Samteks Makina, Insaat, Taahhut, Tekstil, Imalat Sanayi  
Ticaret LTD Sikreti” sh.p.k. me NIPT 7420380362  
Adresa: Rruga “Hançerli Mahallesi Abbasaga”, Sokak Nr. 10  
Ilkadim, Samsun, Turqi.

**Procedura e prokurimit:** “Procedure e Hapur” me mjete elektronike – Mallra

**Numri i references i procedures:** REF-77564-08-16-2023

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Blerje rroba pune”.

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):** Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 70, Datë  
21.08.2023.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. OE “Univers Promotions” sh.p.k.** me NIPT K81324039M  
Vlera 10,464,000 (dhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) Lekë pa TVSH.
- 2. OE “MALBERTEX” sh.p.k.** me NIPT K71821009N  
Vlera 12,726,200 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind)  
Lekë pa TVSH.
- 3. BOE “ALB-GERALD 2023” sh.p.k.** me NIPT M31910029T  
“Samteks Makina, Insaat, Taahhut, Tekstil, Imalat Sanayi Ticaret LTD  
Sikreti” me NIPT 7420380362

Vlera 12,999,969 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. OE “Univers Promotions” sh.p.k., me NIPT K81324039M, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike, për mallrat e paraqitura, pasi nga analizat e bëra pranë një laboratorit të akredituar në Republikën e Shqipërisë, në fushën e tekstil-konfeksioneve, për treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi për të vërtetuar pajtueshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, rezulton si vijon:

Është kërkuar në Specifikimet Teknike	Rezultatet nga analizat e Laboratorit
<b>KOSTUM PUNE DIMRI (BLU) (XHAKETË DHE PANTALLONA)</b>	
Materiali 60% pambuk, 40% polyester	Materiali 40% pambuk, 60% polyester
Lageshtia 5%	Lageshtia 3.8%
Percaktimi i hollësisë së fillit NmB=11.5/1, NmI=23.4/1	Percaktimi i hollësisë së fillit NmB=40/2, NmI=40/2
Rezistenca dhe padeformueshmëria për larje në 60 grade C	Rezistenca dhe padeformueshmëria për larje në 40 grade C
<b>KOSTUM PUNE DIMRI (PORTOKALLI) ME SHIKUESHMËRI TË LARTË (XHAKETË DHE PANTALLONA)</b>	
Dendësia e bazes dhe indit B= 282 ±2	Dendësia e bazes dhe indit B= 275
Percaktimi i masës 240 g/m <sup>2</sup>	Percaktimi i masës 230 g/m <sup>2</sup>
Trashësia 0.72 mm	Trashësia 0.7 mm
Percaktimi i hollësisë së fillit NmB=11.5/1, NmI=23.4/1	Percaktimi i hollësisë së fillit NmB=42/1, NmI=42/1
<b>KOSTUM PUNE DIMRI (GRI) (XHAKETË DHE PANTALLONA)</b>	
Materiali 60% pambuk, 40% polyester	Materiali 40% pambuk, 60% polyester
Percaktimi i masës 245 g/m <sup>2</sup>	Percaktimi i masës 230 g/m <sup>2</sup>
Trashësia 0.72 mm	Trashësia 0.7 mm
Lageshtia 5%	Lageshtia 4%
Percaktimi i hollësisë së fillit NmB=11.5/1, NmI=23.4/1	Percaktimi i hollësisë së fillit NmB=42/1, NmI=42/1
<b>KOMINOSHE (PORTOKALLI)</b>	
Pesha: 270 gr/mq	Pesha: 241 gr/mq
<b>KOMINOSHE (GRI)</b>	
Pesha: 270 gr/mq	Pesha: 240 gr/mq

**2. OE “MALBERTEX” sh.p.k., me NIPT K71821009N, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2/a, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, të DST.

Nuk ka përmbushur pikën 2/b, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, të DST.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.2, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit/ve ose distributorit të autorizuar, për mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.3, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur certifikim ISO 45001:.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.4, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur katalog të prodhuesit për mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.5, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur mostrat pranë AK, sipas kërkesës.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.6, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur, vetëdeklarimin për pranimin e bërjes së analizave të mostrave.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për disponimin e punonjësve.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratë që mallrat janë të reja.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për verifikimin e gjendjes gjyqësore.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “ALB-GERALD 2023” sh.p.k.**, me **NIPT M31910029T** Adresa: Njesia Administrative 11, Rruga “Ramadan Sokoli”, Godina Nr. 36, Laprakë, Tiranë, & **“Samteks Makina, Insaat, Taahhut, Tekstil, Imalat Sanayi Ticaret LTD Sikreti” sh.p.k.**, me **NIPT 7420380362** Adresa: Rruga “Hançerli Mahallesi Abbasaga”, Sokak Nr. 10 Ilkadim, Samsun, Turqi, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **12,999,969 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**ADMINISTRATOR I OST SH.A.**

**Skerdi Drenova**